

VENDIM
Nr. 4, datë 5.12.2019

PËR CAKTIMIN E KOORDINATORIT KOMBËTAR PËR VLERËSIMIN E
DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE

Në mbështetje të nenit 19, të ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, dhe të vendimit nr.750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Lezhë dhe Tiranë”, Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile, në zbatim të masave të marra pas shpalljes së fatkeqësisë natyrore në qarqet e Durrësit, Lezhës dhe të Tiranës, i mbledhur sot më 5.12.2019,

VENDOSI:

1. Caktimin e znj. Milva Ekonomi me detyrën e Koordinatorit Kombëtar për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26.11.2019.
2. Vlerësimi i dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore të bëhet në përputhje me metodologjinë PDNA (vlerësimi i nevojave pas fatkeqësisë), që përdoret nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian dhe PNUD-i.
3. Koordinatori Kombëtar raporton te drejtuesi qendror i operacionit për menaxhimin e fatkeqësisë natyrore çdo javë ose me kërkesë të tij.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KOMITETIT NDËRMINTOR
I EMERGJENCAVE CIVILE
KRYEMINISTRI
Edi Rama